


“TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË”

Bashkia Durrës

Kjo analizë u përgatit nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në emër të rrjetit të organizatave “Zëri i të rinjve”, me mbështetjen e UNFPA-së.

Dhjetor 2018



Autor:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për Ietje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori)

Rr. "Blv. Bajram Curri" Nd. 136, H. 14, Ap. 1

Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00355 42 258 987

Email: info@observator.org.al

Webmail: www.observator.org.al

Kjo analizë është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos Mbetet Pas"), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t'i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

EKSPERTE E ANALIZËS

Monika Kocaqi

EKIPI MENAXHUES

Elma Tërshana

Eridjona Vallja

Andi Rabiaj

Dafina Munda

SUPERVIZUESE

Elida Nuri

Një falenderim i shkon stafit të Bashkisë së Durrësit, që ka bashkëpunuar me Observatorin dhe ka mundur të dhënat ndër vite mbi aktivitetet dhe buxhetin e planifikuar dhe realizuar për të rejtat dhe të rinjtë. Në veçanti, falenderojmë Z. Vangjush Dako – Kryetar i Bashkisë Durrës, Z. Florian Tahiri – Nën Kryetar i Bashkisë Durrës dhe Znj. Meme Xhaferaj – Drejtore e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Durrës.

Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit në emër të rrejtit të organizatave "Zëri i të rinjve". Opinionet e shprehura këtu janë të autorëve/eve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së.

PËRSE BUXHETIMI “PËR RININË” DHE “ME RININË”?

Rinia në Shqipëri është pjesë e programit dhe politikave të qeverisë dhe citohet si grup prioritar në dokumenta të veçantë të hartuar për këtë qëllim. Ofrimi i një tërësie shërbimesh dhe informacionesh edukuese në fushën e shëndetësisë, arsimit, punësimit, zhvillimit ekonomik, kulturës, sportit, argëtimit, mjedisit e vullnetarizimit, si dhe angazhimi i rinisë në proceset planifikuese e vendimmarrëse, është domosdoshmëri¹. Këto shërbime mund dhe duhet të ofrohen kryesisht nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore (bashkitë), të cilat janë më afër qytetar/eve dhe njohin më mirë nevojat e tyre.

Të rejtat dhe të rinjtë duhet të jenë pjesë e iniciativave planifikuese e zhvilluese të ndërmarra si në nivel qendror, ashtu edhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sidomos nga bashkitë.

Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” në nenin 38 pika 2 të tij kërkon shprehimisht që, pas finalizimit të projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit². Në këtë kuadër, bashkitë mund dhe duhet të mbështetin iniciativat e tyre planifikuese buxhetore për të rejtat dhe të rinjtë në nevojat e këtij grupi, duke u udhëhequr dhe zbatuar legjislacionin në fuqi dhe dokumentat kryesorë strategjikë të hartuar për këtë qëllim. Si dy nga më të rëndësishmet mund të përmendim:

1. Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si një nga ligjet bazë mbi të cilin organizojnë punën dhe funksionojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, ka të shprehur qartësisht detyrimin dhe përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të rinisë. Konkretisht këto detyrime evidentohen në:

- (i)** nenin 3, ku përcaktohet misioni i vetëqeverisjes vendore, në pikat d), dh) dhe f) sipas të cilave realizimi i shërbimeve duhet të bëhet në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e antar/eve të bashkësisë, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj apo akte të tjera normative, si dhe përmes nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- (ii)** nenin 23, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (kryesisht në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore apo zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në fushën e shëndetësisë, etj);
- (iii)** nenin 24, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e shërbimeve sociale;
- (iv)** nenin 25, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- (v)** nenin 26, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- (vi)** nenin 28, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;
- (vii)** nenin 29, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e sigurisë publike.

Garantimi i pjesëmarrjes publike të grupeve të ndryshme shoqërore në procesin e vendimmarrjes shprehet qartësisht edhe në nenin 16 të këtij ligji, ku përcaktohet detyrimi për konsultime publike në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (PKVR) 2015-2020, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 383, datë 6 maj 2015, është një ndër dokumentat kryesorë që udhëheq punën e qeverisjes qendrore, si dhe të njëjsteve të vetëqeverisjes vendore për veprime dhe masa për të rejtat dhe të rinjtë në Shqipëri.

¹Fushat e mësipërme përbëjnë dhe thelbin e objektivave të përgjithshme të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020

²Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 38, pika 2, fq. 16

Qëllimi i këtij plani është zhvillimi dhe koordinimi i politikave ndërsektoriale rinore në edukim, punësim, shëndetësi e kulturë, si dhe forcimi i pjesëmarrjes së të rejave e të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimmarrëse. Misioni i Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015–2020 qartësisht evidenton nevojën për “*përmirësim të cilësisë së jetës së të rejave e të rinjve dhe forcim të statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë, si dhe rritje të pjesëmarrjes së plotë të tyre në shoqëri dhe vendimmarrje*”³. Bazuar mbi këtë dokument strategjik, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të hartojnë dhe zbatojnë planet e tyre të veprimit në nivel vendor, duke synuar përmbushjen e misionit dhe qëllimit të sipërcituar.

SI PARAQITET SITUATA NË BASHKINË DURRËS ?

Në planifikimet dhe ndërhyrjet në shërbim të komunitetit – pra përfshirë edhe rininë – Bashkia Durrës orientohet, veç të tjerash, përmes: (i) Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, (ii) Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen Sociale ku është i përfshirë edhe kujdesi shëndetësor, (iii) Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Shërbimet Sociale ku sërisht është përfshirë edhe kujdesi shëndetësor, si dhe (iv) Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020, të hartuar në përputhje me Kartën Evropiane për Barazi të burrave dhe grave në jetën vendore⁴, ku parashikohen një sërë veprimesh specifike që targetojnë të rejtat dhe të rinjtë në fushën e vendimmarrjes, shëndetësisë, punësimit, arsimit, kulturës e sportit. Ndërsa në terma buxhetorë, bashkia Durrës vepron në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe përgatit Planet Buxhetore Afatmesme (konkretisht është miratuar ky plan për periudhën 2018–2020), mbi bazën e të cilit, në përputhje me ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore, bëhet dhe planifikimi buxhetor vjetor.

Bazuar në informacionin e dhënë nga bashkia, situata në lidhje me të rejtat dhe të rinjtë paraqitet si në vijim:

- Bashkia Durrës *nuk disponon një shifër të saktë* të numrit të të rejave dhe të rinjve të grupmoshës 15–29 vjeç.
- Në Durrës ka gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) shkolla të mesme, 3 (tre) universitete dhe 1 (një) qendër shumëfunktionale. *Nuk ka asnjë qendër rinore.*
- Ekzistojnë dy organizata lokale që kanë në fokus të rejtat dhe të rinjtë, konkretisht Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (CSDC) dhe Organizata “Zëri 16+”.
- Ekziston një *Këshill Rinor* i ngritur me iniciativën e Qendrës për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (CSDC) që në vitin 2015, i cili ka në përbërjen e tij 15 antar/e të përzgjedhur/a bazuar në dëshirën e tyre për t’u aktivizuar si pjesë e këtij bordi.
- *Nuk ekziston një plan sektorial për rininë* (që të bazohet dhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë), por prioritetet për këtë grup janë parashikuar në planet e ndryshme të përgatitura nga bashkia, përfshirë dhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020.
- Bashkia *ka zbatuar kryesisht aktivitetet edukuese për të rejtat dhe të rinjtë* në tre vitet e fundit (2015–2017) të cilët janë realizuar si pjesë e fushatave ndërgjegjësuese. Më konkretisht të rinjtë janë përfshirë aktivisht në fushatat e ndërgjegjësimit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në fushatat e ndërgjegjësimit për luftën kundër kancerit të gjirit apo kundër sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, si dhe në diskutimet në lidhje me çështjet e shëndetit mendor, përmes orëve të hapura të zhvilluara në universitete.

³Planit Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015–2020, fq.9

⁴ http://www.ccre.org/docs/charte_egalite_en.pdf

- Për vitin 2018, të rejat dhe të rinjtë janë përfshirë në aktivitete edukuese kundër tuberkulozit, të zhvilluara në Qendrën Multifunkionale në Nish Tulla; takime në kuadër të buxhetimit me pjesëmarrje; si dhe në aktivitete sensibilizuese për nxitjen e punësimit të të rejave dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, të cilat po zhvillohen në bashkëpunim me Code Albania dhe me mbështetjen e Ambasadës Gjermane. Gjithashtu në 24.05.2018, Bashkia Durrës ka nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi 2 vjeçare me *Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në emër të rrjetit të organizatave "Zëri i të Rinjve"*, me qëllim mobilizimin, integrimin dhe fuqizimin e potencialeve të të rejave dhe të rinjve përmes shërbimeve ndërgjegjësuese, informuese, avokuese e lobuese, në fushat e edukimit, kujdesit, shëndetit dhe punësimit.
- Bashkia *ka shtuar në përshkrimin e punës të Specialistes së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve disa përgjegjësi për shëndetin si dhe për marrje dhe shkëmbim informacioni me Drejtorinë e Rajonale të Shëndetësisë*. Ky vendim u mor në kuadër të zbatimit të një projekti të përbashkët me Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë, të mbështetur nga UNICEF. Po kështu pranë Këshillit Bashkiak është ngritur në vitin 2017 edhe një *Komision për Shëndetësinë*. Bashkia nuk ka punonjës apo njësi të veçantë dedikuar rinisë.
- Buxheti i bashkisë dedikuar direkt ose indirekt për rininë *është pjesë e buxhetit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale* si dhe e *Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare*. Buxheti për rininë i planifikuar dhe realizuar gjatë tre viteve të fundit *rezulton të ketë pësuar rritje* (madje të dhënat flasin më shumë për rritje të buxhetit të realizuar që tejkalon shifrat e buxhetit të planifikuar), siç paraqitet në tabelën në vijim:

VITI	KATEGORIA	BUXHETI I PLANIFIKUAR (LEKË)	BUXHETI I REALIZUAR (LEKË)
2015	Shërbimet Sociale	13,000,000	13,000,000 (PAK + NE)
	Arsimi dhe Sportet	20,629,000	20,629,000, nga të cilët: - 8,729,000 për bursa - 11,900,000 për mirëmbajtje të shkollave të mesme
2016	Shërbimet Sociale	13,500,000	13,500,000 (PAK + NE)
	Arsimi dhe Sportet		55,613,000, nga të cilët: - 26,088,000 për bursa - 14,525,000 për mirëmbajtje dhe - 15,000,000 për investime
2017	Shërbimet Sociale	14,300,000	14,300,000 (PAK + NE)
	Arsimi dhe Sportet		55,613,000, nga të cilët: - 26,088,000 për bursa - 14,525,000 për mirëmbajtje dhe - 15,000,000 për investime
	Shërbimet Sociale	22,461,720 (PAK + NE)	
	Arsimi dhe Sportet	91,000,000 (investime)	

- Njoftimet e ndryshme mbi edukimin, trajnimin apo bursat për të rejat dhe të rinjtë pasqyrohen online në faqen e internetit të bashkisë: www.durres.gov.al

- Bashkia *nuk ka bërë ndonjë vlerësim/anketim për të identifikuar nevojat dhe prioritetet* e të rejave dhe të rinjve në Durrës. Këshilli Bashkiak *ka organizuar një seancë dëgjimore për problemet e rinisë* ku në qendër të diskutimeve ka qenë çështja e qendrës rinore. Zakonisht të rejat dhe të rinjtë kanë mundësi të përcjellin problemet dhe shqetësimet e tyre pranë bashkisë përmes strukturave përkatëse që i përfaqësojnë, të tilla si: Këshilli Rinor, Komisioni Këshillimor Qytetar dhe Zëri 16+. Kur pyetet për rëndësinë e aktiviteteve me fokus shëndetin seksual e riprodhues, si dhe ato sensibilizuese për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor, bashkia i vlerëson si aktivitete tepër të rëndësishme, së bashku me: pasjen e një manuali shpjegues për të rejat e të rinjtë për t'u njohur me të drejtat e tyre mbi shëndetin e kujdesin shëndetësor; shkëmbimin e eksperiencave mes të rejave e të rinjve nga bashki të ndryshme me ndërmjetësimin e drejtuesve vendorë, e të tjera.

Ndërkohë, nga një anketim i kryer nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, me 100 të reja e të rinj të bashkisë Durrës (71% vajza dhe 50% nga zonat rurale konkretisht nga Shkolla e Bashkuar Kullë dhe Shkolla "Njazi Mastori" Sukth), gjatë periudhës prill-maj 2018, rezulton se:

- Afërsisht *1 në 6 të reja dhe të rinj* kanë dëgjuar se çfarë janë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals – SDGs). *Interneti* është burimi kryesor i marrjes së këtij informacioni nga 50% e të rejave dhe të rinjve të zonave urbane dhe 80% e tyre në zonat rurale. *Shkolla* dhe *Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)* janë cituar gjithashtu si burim informacioni për të rejat dhe të rinjtë, ndërkohë që *institucionet vendore* dhe familja nuk janë përmendur në asnjë rast si burim informacioni për të rejat dhe të rinjtë nga zonat urbane e rurale, në lidhje me SDG-të.
- Vetëm *14% e të rejave dhe të rinjve të grupmoshave të ndryshme* shprehen se *janë përfshirë pjesërisht në arritjen e SDG-ve*, ndërsa *7% e të rejave dhe të rinjve* të grupmoshës 24–29 vjeç shprehen se *dëshirojnë të përfshihen, por nuk kanë informacionin* e nevojshëm se si mund të ndodhë kjo gjë.
- *1 në 11 të reja dhe të rinj nuk kanë marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues.*
- Të rejat dhe të rinjtë *më të informuar* mbi shëndetin seksual dhe riprodhues janë *vajzat në zonat urbane (37%)*, ndërsa *më pak të informuar* janë *djemtë në zonat rurale (12%)*. Shkolla dhe interneti janë burimi më i shpeshtë i informacionit të përdorur për pasurimin e njohurive të të rejave dhe të rinjve mbi këtë çështje.
- *Shumica e të rejave dhe të rinjve (37%)* shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është *pjesërisht i mjaftueshëm*. Mbi *23% e të rejave dhe të rinjve në zonat rurale* shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është *i mjaftueshëm*, përkundrajt *8% të të rejave dhe të rinjve në zonat urbane*. Zakonisht janë vajzat (si në zonat urbane dhe në ato rurale) që shprehen për pamjaftueshmërinë e informacionit të marrë.
- *Asnjë prej të rejave dhe të rinjve në zonat rurale* dhe *60% e të rejave dhe të rinjve në zonat urbane NUK flasin me prindërit* e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues. Vetëm *24% e të rejave dhe të rinjve në zonat urbane* pohojnë se flasin me prindërit e tyre (në asnjë rast me babain, por vetëm me nënën). *2% e të rejave dhe të rinjve në zonat rurale dhe e njëjta përqindje në zonat urbane* shprehen se *prindërit nuk i lejojnë* të komunikojnë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues në familjet e tyre.

- *1 në 5 të reja dhe të rinj* janë në djepi të programeve / prioriteteve të bashkisë në lidhje me rininë (kryesisht vajzat në zonat rurale, në masën 45%). Ndërsa grupi më pak i informuar janë djemtë nga zonat urbane dhe rurale (në të njëjtën masë, 15%).
- Shumica e të rejave dhe të rinjve (64% në zonat urbane dhe 82% në zonat rurale) shprehen se *NUK kanë marrë ndonjëherë pjesë në takimet* që bashkia ka zhvilluar me të rejat dhe të rinjtë për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit të zonës. Ndërsa 16% e të rejave dhe të rinjve në zonat urbane dhe 4% e të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale shprehen se *marrin pjesë ndonjëherë ose shpesh* në takimet e bashkisë. Njoftimet publike (për 16% të të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale) dhe Portali On-line (për 20% të të rejave dhe të rinjve nga zonat urbane) janë mjetet më të përdorura për marrjen e informacionit nga bashkia.
- *Ofrimi i mjediseve të gjelbërta dhe takimet e vazhdueshme informuese* janë programet më të preferuara që të rejat dhe të rinjtë do të donin të përfitonin nga bashkia e Durrësit. Gjithashtu të rejat dhe të rinjtë kanë identifikuar si shërbime të preferuara edhe ofrimin e mundësive të punësimit, përfshirjen në vendimmarrje dhe ofrimin e bazës materiale në shkolla.

PËRSE BUXHETIMI “PËR RININË” DHE “ME RININË”?

Bashkia Durrës, në përbushje të detyrimeve dhe përgjegjësive të saj për përmirësimin e situatës së të rejave dhe të rinjve durrak/e, si dhe në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015–2020 dhe të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020, mund të përfshijë në planifikimin buxhetor për vitin 2019 disa nga veprimet që përshkruhen në vijim:

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	SHËNIME
1. Nxitja dhe pjesëmarrja e të rejave dhe të rinjve në proceset dhe vendimmarrjet demokratike	1.1. Riaktivizimi i Këshillit Rinor duke respektuar balancën gjinore si dhe përfaqësimin e të rejave dhe të rinjve nga grupe të pafavorizuara (persona me aftësi të kufizuara, minoriteti Rom, Egjiptjan, komuniteti LGBTI, etj).	Gjatë gjithë vitit 2019	<p>- Lista e përditësuar e anëtarëve të Këshillit Rinor, publikuar në faqen e internetit të bashkisë.</p> <p>- Pjesëmarrja dhe diskutimi i tyre pasqyruar në proces-verbalet e mbledhjeve përkatëse.</p>	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 1, aktivitetin 1.2.2 të PKVR 2015-2020. Ai mund të kryhet në bashkëpunim me CSDC-në, rrjetin e organizatave "Zëri i të rinjve", organizatën "Zëri 16+", si dhe me të rejtat dhe të rinjtë në shkolla.
	1.2. Përfshirja e dimensionit gjinor dhe rëndësisë së pjesëmarrjes së barabartë në përfaqësimin dhe jetën politike, në sesione për edukimin qytetar, në shkollat publike (të mesme)	Gjatë gjithë vitit 2019	<p>- Numri i aktiviteteve me fokus diskriminimin gjinor dhe përfshirjen e rinisë në vendimmarrje, të organizuara nga bashkia në shkollat e mesme të qytetit.</p> <p>- Numri i të rejave dhe të rinjve të pranishëm si dhe që japin mendim në mbledhjet e Këshillit Bashkiak apo seancat / dëgjesat publike që organizon bashkia për çështje të ndryshme.</p>	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 1, aktivitetin 1.2.3 të PKVR 2015-2020. Gjithashtu ky aktivitet është planifikuar edhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020, konkretisht në Qëllimin Strategjik 2, Objektivin Specifik 2.1., Aktiviteti 2.1.2 dhe ka përgjegjëse kryesore për zbatim Drejtorinë e Shërbimeve Sociale. <i>Këto veprime do të realizohen gjatë vitit 2019.</i> Gjithashtu në dëgjesat publike për buxhetin Afat Mesëm dhe të vitit 2019 të realizuara në datat 5,6,7
	1.3. Takime sensibilizuese me të rejtat e zonave rurale, si dhe me të rejtat me aftësi të kufizuara, mbi	Janar – Mars 2019	<p>- Numri i takimeve sensibilizuese të organizuara</p> <p>- Numri</p>	Nëntor u pa me vëmendje pjesëmarrja e të rinjve. Organizatat e të rinjve dhe grupi këshillimor janë njoftuar për të marrë pjesë.

	rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të tyre në procesin e votimit (individual e të lirë), në zgjedhjet vendore		i pjesëmarrëseve disagreguar sipas zonave, moshës, aftësive dhe njësisve administrative	Ky aktivitet është planifikuar edhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020, konkretisht në Qëllimin Strategjik 2, Objektivin Specifik 2.1, Aktiviteti 2.1.1 dhe ka përgjegjëse kryesore për zbatim Drejtorinë e Shërbimeve Sociale
	1.4. Lehtësimi i pjesëmarrjes në zgjedhjet vendore 2019 të të rejave e të rinjve të komunitetit Rom, përmes pajisjes së tyre me kartat e identitetit	Janar–Maj 2019	Numri i kartave të identitetit të nxjerra, disagreguar sipas seksit, moshës, NJA të personave nga Komuniteti Rom	Ky aktivitet është planifikuar edhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020, konkretisht në Qëllimin Strategjik 2, Objektivin Specifik 2.1, Aktiviteti 2.1.3 dhe ka përgjegjëse kryesore për zbatim Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, do të realizohet në bashkëpunim me QKM në Nish tulla.
	1.5. Takime sensibilizuese me nxënëset/it e shkollave 9–vjeçare dhe të mesme në ambientet e bashkisë, për të mundësuar konceptin e qeverisjes së hapur dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët	Janar–Maj 2019	Numri i takimeve të zhvilluara, disagreguar sipas seksit, moshës, shkollave, etj	Ky aktivitet është planifikuar edhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020, konkretisht në Qëllimin Strategjik 2, Objektivin Specifik 2.1., Aktiviteti 2.1.5 dhe ka përgjegjëse kryesore për zbatim Drejtorinë e Shërbimeve Sociale. <i>Pjesë e kalendarit vjetor 2019 të aktiviteteve.</i>
	1.6. Takime informuese me të reja dhe të rinj nga grupet e pakicave, mbi çështjet e steriotipeve gjinore, diskriminimit të shumëfishtë dhe rëndësisë së ngritjes së zërit të tyre dhe adresimit të shqetësimeve pranë Bordit Këshillimor të Qytetit	Tetor – Dhjetor 2019	– Numri i takimeve të organizuara – Numri i pjesëmarrës/eve, i disagreguar sipas seksit, moshës, njësisve administrative dhe grupeve të pakicave që iu përkasin	Ky aktivitet është planifikuar edhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020, konkretisht në Qëllimin Strategjik 2, Objektivin Specifik 2.2., Aktiviteti 2.2.1 dhe ka përgjegjëse kryesore për zbatim Drejtorinë e Shërbimeve Sociale. <i>Pjesë e kalendarit vjetor 2019 të aktiviteteve.</i>

<p>2. Nxitja e punësimit të të rejave dhe të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës</p>	<p>2.1. Vlerësimi i kërkesës së tregut të punës dhe traditës apo nevojave specifike të Durrësit, në lidhje me kurset e formimit profesional që mund të ofrohen nga Agjensia e Formimit Profesional (AFP) për të rejtat dhe të rinjtë durrak/e.</p>	<p>Janar–Mars 2019</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Raporti i vlerësimit të situatës - Propozimet drejtuar AFP dhe Zyrës Rajonale të Punësimit (ZRP) Durrës mbi kurset e reja të formimit profesional që duhet të hapen në Durrës. - Numri i kurseve të reja të hapura nga AFP. 	<p>Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 2, aktivitetin 2.2.6 të PKVR 2015–2020.</p> <p>Ai duhet të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me AFP dhe ZRP Durrës, si dhe me bizneset ekzistuese të zonës.</p>
	<p>2.2. Organizimi i takimeve sensibilizuese me të rejtat dhe të rinjtë mbi rëndësinë e ndjekjes së kurseve të formimit profesional të bazuara në nevojat dhe specifikat e zonës.</p>	<p>Prill –Dhjetor 2019</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i takimeve të organizuara në shkollë. - Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e në këto takime. - Numri i të rejave dhe të rinjve të regjistruar/a në kurset e formimit profesional. 	<p>Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 2, aktivitetin 2.2.7 të PKVR 2015–2020.</p>
	<p>2.3. Mbështetja e aktiviteteve që nxisin vetëpunësimin e të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale</p>	<p>Gjatë gjithë vitit 2019</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i aktiviteteve vetëpunësuese të mbështetura. - Numri i të rejave dhe të rinjve të vetëpunësuar/a. 	<p>Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 2, aktivitetin 2.3.4 të PKVR 2015–2020.</p>
	<p>2.4. Seminare informuese dhe trajnuese me nxënës/et e shkollave të mesme mbi rëndësinë e të sfiduarit të stereotipeve gjinore në punësim</p>	<p>Shtator – Nëntor 2019</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i seminareve të organizuara - Lista e pjesëmarrës/eve disagreguar sipas seksit, moshës, klasës dhe njësive administrative 	<p>Ky aktivitet është planifikuar edhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020, konkretisht në Qëllimin Strategjik 3, Objektivin Specifik 3.1., Aktiviteti 3.1.1 dhe ka përgjegjëse kryesore për zbatim Drejtorinë e Shërbimeve Sociale <i>Pjesë e kalendarit vjetor të aktiviteteve.</i></p>
	<p>2.5. Mbështetja me bursa e të rejave dhe të rinjve nga familje në nevojë, për kryerjen e shkollave të formimit profesional në qytetin e Durrësit.</p>	<p>Janar – Shkurt 2019</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i të rejave dhe të rinjve të mbështetur me bursa, disagreguar sipas seksit, moshës, profesionit të përzgjedhur, etj 	<p>Ky aktivitet është planifikuar edhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020, konkretisht në Qëllimin Strategjik 3, Objektivin Specifik 3.1., Aktiviteti 3.1.2 dhe ka përgjegjëse kryesore për zbatim Drejtorinë e Shërbimeve Sociale. <i>Pjesë e buxhetit për vitin shkollor 2018–2019.</i></p>

	2.6. Krijimi i programit për nxitjen e punësimit të të rejave dhe të rinjve në Bashki	Gjatë vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> - Kategoritë e programeve të ofruara - Numri i përfitues/eve, disagreguar sipas seksit, moshës, etj 	Ky aktivitet është planifikuar edhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020, konkretisht në Qëllimin Strategjik 4, Objektivin Specifik 4.1, Aktiviteti 4.1.1 dhe ka përgjegjëse kryesore për zbatim Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit.
3. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete mjedisore dhe turistike	3.1. Nxitja e pjesëmarrjes aktive të të rejave dhe të rinjve në hartimin dhe monitorimin e politikave mjedisore dhe turistike në nivel lokal.	Gjatë vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë aktivisht në seancat e Këshillit Bashkiak, dëgjesat publike apo aktivitetet mbi mjedisin, të organizuara nga bashkia. 	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 3, aktivitetin 3.7.2 të PKVR 2015-2020.
	3.2. Aktivitete pastrimi, pyllëzimi apo riciklimi me qëllim rritjen e sensibilitetit të të rejave dhe të rinjve, si dhe komunitetit në tërësi mbi mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e turizmit.	Gjatë vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i aktiviteteve sensibilizuese të organizuara. - Numri i aktiviteteve për promovimin e turizmit. - Numri i pemëve të mbjella dhe sasia e plehrave të grumbulluara apo ricikluara. 	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 3, aktivitetin 3.7.5 të PKVR 2015-2020.
	3.3. Aktivitete sensibilizuese mbi mjedisin dhe ndikimin e tij në shëndetin e gjeneratës së re.	Gjatë vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i aktiviteteve të zhvilluara. - Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e. 	Ky veprim mund të jetë pjesë e aktiviteteve që duhet të organizojë Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki. <i>Pjesë e buxhetit për vitin shkollor 2018-2019.</i>
4. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete artistike e kulturore	4.1. Mbështetje për grupet e reja rinore kulturore dhe artistike (këngë, teatër, animacione) të krijuara nga të rejat dhe të rinjtë e shkollave të Durrësit dhe përfshirja e tyre në ngjarje apo festa të rëndësishme të qytetit.	Gjatë vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i grupeve të reja rinore të mbështetura. - Numri i aktiviteteve të bashkisë në të cilat janë të ftuara dhe kanë performuar këto grupe rinore. 	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 6, aktivitetin 6.1.2 të PKVR 2015-2020.

	4.2. Promovimi i jetës artistike dhe kulturore përmes organizimit të aktiviteteve artistike-kulturore edhe në zonat rurale.	Gjatë vitit 2019	– Numri i aktiviteteve artistike-kulturore të organizuara me mbështetjen e bashkisë, në zonat rurale, me grupet rinore.	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 6, aktivitetin 6.2.1 të PKVR 2015–2020.
	4.3. Programe sensibilizuese në mediat lokale mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në veprimtari sportive, artistike dhe kulturore, përfshirë edhe ato që tradicionalisht shihen si aktivitete kryesisht “Femërore” ose “Mashkullore”	Gjatë vitit 2019	– Numri i programeve të realizuara – Përqindja e audiencës së arritur në varësi të shikueshmërisë televizive	Ky aktivitet është planifikuar edhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020, konkretisht në Qëllimin Strategjik 3, Objektivin Specifik 3.5., Aktiviteti 3.5.1 dhe ka përgjegjëse kryesore për zbatim Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare.
5. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete edukuese shëndetësore	5.1. Aktivitete që promovojnë një kulturë të hapur dhe të lirë rreth shëndetit seksual, për të ulur stigmatizmin dhe diskriminimin.	Gjatë vitit 2019	– Numri i aktiviteteve të zhvilluara në shkollat e qytetit dhe në zonat rurale. – Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë.	Ky veprim mund të jetë pjesë e aktiviteteve që duhet të organizojë Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki. <i>Pjesë e buxhetit për vitin shkollor 2018-2019.</i>
	5.2. Krijimi dhe mbështetja e grupeve “edukatorë bashkëmohatarë” (“peer education groups”) për nxitjen e organizimit të aktiviteteve edukuese shëndetësore mes të rejave dhe të rinjve në zonat rurale, si dhe në komunitetin Rom, Egjiptjan, LGBTI, etj.	Gjatë vitit 2019	– Grupet e “edukatorëve bashkëmohatarë” të krijuara – Numri i aktiviteteve të organizuara nga grupet e “edukatorëve bashkëmohatarë” me të rejat dhe të rinjtë e zonave apo komuniteteve të caktuara	Ky veprim mund të jetë pjesë e aktiviteteve që duhet të organizojë Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki, në bashkëpunim me Rrjetin e organizatave “Zëri i të rinjve”, CSDC–në dhe Zëri 16+.
	5.3. Konkurse mes shkollave të mesme mbi rolin e qeverisjes vendore në çështje të shëndetit seksual dhe riprodhues.	Gjatë ditëve dedikuara shëndetit përgjatë vitit 2019	– Numri i aktiviteteve të zhvilluara në shkollat e qytetit dhe në zonat rurale.	Ky veprim mund të jetë pjesë e aktiviteteve që duhet të organizojë Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki.

	shëndetit seksual dhe riprodhues.		Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë.	<i>Pjesë e buxhetit për vitin shkollor 2018-2019</i>
	5.4. Ngritja / përmirësimi i shërbimit shëndetësor për gratë, të rejtat dhe vajzat në Manëz	Gjatë vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> - Lloji i shërbimit të ofruar - Numri i grave/të rejave/vajzave të diagnostifikuaradisag reguar sipas moshës, diagnozës, etj 	Ky aktivitet është planifikuar edhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020, konkretisht në Qëllimin Strategjik 3, Objektivin Specifik 3.2., Aktiviteti 3.2.5 dhe ka përgjegjëse kryesore për zbatim Drejtorinë e Shërbimeve Sociale. <i>Pjesë e buxhetit për vitin shkollor 2018-2019.</i>
6. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrushëm (Sustainable Development Golas – SDGs)	6.1. Aktivitete informuese mbi SDG-të me qëllim njohjen e tyre dhe sensibilizimin e të rejave dhe të rinjve mbi rolin që mund dhe duhet të luajnë për përmbushjen e këtyre objektivave	Gjatë vitit 2019	- Numri i aktiviteteve me fokus SDG-të, të organizuara nga bashkia në bashkëpunim me Rrjetin “Zëri i të rinjve” CSDC-në, Zëri 16+ dhe shkollat e mesme të qytetit.	Në realizimin e aktiviteteve të tilla mund të angazhohet jo vetëm Nëpunësja e Barazisë Gjinore por edhe stafi përgjegjës në bashki për çështje të edukimit.
	6.2. Mbështetja e iniciativës “Rinia durrsake për SDG-të”, përmes hartimit dhe financimit për zbatimin e një plani veprimesh konkrete në këtë drejtim		<ul style="list-style-type: none"> - Dokumenti i Planit të Veprimeve për arritjen e SDG-ve përmes kontributit të të rejave dhe të rinjve durrsak/e. - Numri i iniciativave të financuara nga bashkia, për t’u zbatuar nga të rejtat dhe të rinjtë durrsak/e në kuadër të SDG-ve 	Bashkëpunimi me Rrjetin “Zëri i të rinjve”, CSDC-në, Zëri 16+, si dhe me akademikët dhe median, lehtëson zhvillimin e aktiviteteve të tilla dhe ndihmon në prezantimin e ideve inovative për të kontribuar për arritjen e SDG-ve

	<p>6.3. Panairi i ideve në kuadër të "Ditës Botërore të Aftësive të të rejave dhe të rinjve", bazuar në trajnimet e formimit profesional të ofruara mbi bazën e nevojave dhe karakteristikave të zonës</p>		<p>- Panairi i organizuar në bashkëpunim me AFP dhe ZRP -Numri i ideve të prezantuara -Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e</p>	<p>Ky aktivitet është në përputhje me SDG 4 "Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës e të barabartë për të gjithë dhe nxitja e mundësive të të nxëniet gjatë gjithë jetës"</p> <p>Aktiviteti mund të kombinohet (dhe kontribuon) edhe me veprimet e planifikuara në qëllimin 2, të fokusuar tek rinia dhe nxitja e punësimit (siç paraqiten më sipër në këtë tabelë)</p>
--	--	--	--	--

ÇFARË HAPASH DUHET TË HEDHË BASHKIA PARALELISHT ME PËRFSHIRJEN NË BUXHETIN E VITIT 2019 TË DISA PREJ VEPRIMEVE TË PROPOZUARA MË SIPËR?

- Të marrë masa të menjëhershme për të siguruar një bazë të saktë të dhënash (databazë) në lidhje me numrin e të rejave dhe të rinjve në qytet dhe zonat rurale pjesë e territorit të bashkisë, duke siguruar që kjo bazë të dhënash të përmbajë detaje mbi gjininë, moshën, nevojat e veçanta të tyre, etninë, etj.
- Të bashkëpunojë me rrjetin dhe organizatat rinore me qëllim ofrimin e modelit për nxitjen e krijimit të grupeve dhe shoqatave rinore, nga të rejtat dhe të rinjtë e tjerë të qytetit dhe të zonave rurale pjesë e territorit të bashkisë.
- Të organizojë sesione të hapura dhe dëgjesa publike me fokus të veçantë të rejtat dhe të rinjtë dhe nevojat e tyre. Për të siguruar pjesëmarrjen në këto sesione e dëgjesa, të organizojë fillimisht takime të shkurtra informuese në shkollat e qytetit dhe të zonave rurale, ku të ftohen të rejtat dhe të rinjtë të bëhen pjesë e dëgjesave që do të organizojë bashkia. Në këto takime duhet të paraqitet dhe kalendari i dëgjesave që mendohet të organizohen. Një kopje e këtij kalendari me datat, oraret dhe vendin e organizimit të këtyre dëgjesave, duhet të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë.
- Të marrë masa për të caktuar një specialist/e që në përshkrimin e punës së saj/tij të ketë detyra që lidhen specifikisht me rininë dhe ndjekjen e prioriteteve të saj.
- Të marrë masa që të koordinojë aktivitetet shëndetësore, edukuese e kulturore me prioritetet që lidhen me rininë në këto drejtime. Të mundësojë shkëmbime eksperiencash me bashki të tjera ku grupimet rinore janë më aktive.
- Të hartojë një plan veprimi lokal për rininë, ku të përmbliqen të gjitha veprimet e parashikuara në dokumenta të tjerë zhvillimorë të bashkisë, por edhe veprime të tjera të dosmosdoshme për adresimin e çështjeve rinore në fusha të ndryshme. Ky plan veprimi duhet të mbështetet në PKVR 2015–2020 si dhe në PVBGJ 2018–2020 (pjesë e këtyre veprimeve janë dhënë në tabelën mësipër me sugjerime për veprimet që duhet të përfshihen në buxhetin e vitit 2019 të bashkisë Durrës, me fokus rininë).
- Të marrë masa që në takimet dhe dëgjesat për përfundimin e buxhetit vjetor 2019, të sigurojë pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve nga grupe të ndryshme (përfshirë edhe nga grupet e pafavorizuara si Romë, Egjiptjanë, PAK, LGBTI, etj). Bashkëpunimi me rrjetin e organizatave “Zëri i të rinjve”, me CSDC-në dhe “Zëri 16+” është i domosdoshëm në këtë drejtim, sidomos për të siguruar pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve nga grupet e ndryshme të sipërcituara, të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale, etj.
- Të sigurojë që, në Këshillin Rinor, të ketë përfaqësim të barabartë jo vetëm në gjini, por edhe duke respektuar karakteristika të tjera të tilla si vendbanimi, moshë, etnia, nevojat e veçanta, orientimi seksual, etj.

SHTOJÇË 1

Aktivitete të realizuara nga Bashkia Durrës në bashkëpunim me organizata të ndryshme

Tema/Fusha	Emri i projektit	Donatori	Kohëzgjatja
Fuqizimi i bordeve të shkollës	Fuqizimi i bordeve të shkollës dhe këshillave të prindërve	World Vision	2016 - në vazhdim
Dhuna në familje, buxheti familjar, shëndeti, komuniteti, martesat e shëndetshme, etj.	Viti i familjes	World Vision, World Hope, Qendra për zhvillim komunitar "Sot për të ardhmen", Qendra Shpresë e Botës, etj.	Janar 2014 - në vazhdim.
Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi problemet e shëndetit mendor e sidomos ndaj AUTIZMIT.	Dita ndërkombëtare ndaj autizmit	Qendra e Shëndetit Mendor "Drejt Zhvillimit", World Vision, World Hope, Qendra për zhvillim komunitar "Sot për të ardhmen", qendra Shpresë e Botës, etj., Qendra për Shërbime bazë komunitare të fëmijëve me AK.	Prill 2016, Prill 2017 Prill 2018
Ndërgjegjësimi i komunitetit, sidomos i të rejave dhe të rinjve mbi martesat e hershme	Martekat e hershme në komunitetet rome dhe egjiptiane	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, Qendra në Nish Tulla etj	Mars 2017
Ndërgjegjësimi i komunitetit, sidomos i të rejave dhe të rinjve mbi sëmundjet seksualisht të trasmetueshme	Dita Ndërkombëtare kundër HIV/AIDS	Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, Qendra Komunitare në Nish Tulla, Shkolla e Kullës etj.	Dhjetor 2016, 2017
Ndërgjegjësimi i komunitetit për rëndësinë e shëndetit	Si të mbrohemi nga TBC	Qendra Komunitare në Nish Tulla, PNUD, Drejtoria Rajonale e Shëndetit, etj	Gjëtë vitit 2017 e në vazhdim (Katër takime në vit)

Projektet që po zbatohen gjatë vitit 2018

Tema/Fusha	Emri i projektit	Donatori	Kohëzgjatja
Forcimi i kapaciteteve rinore në jetën publike dhe politike	Formimi i Liderëve Rinor për mobilizim Komunitar	Olof Palme International Center	Janar 2016 në vazhdim
Forcimi i demokracisë të një grupi të synuar. (Grupi i synuar: 16813 banorë të njësive administrative Manëz dhe Katund i Ri. Numri i përfitues/eve: 25 të rinj – nxënës/e dhe student/e (13 vajza e të reja dhe 12 djem e të rinj)	Forcimi i demokracisë rurale përmes hulumtimit dhe advokacisë	UNDP dhe Bashkia Durrës	Në proces nënshkrimi të kontratës
Tematika sociale / ndërlidhje me pushtetin lokal të të rinjve e të rejave	Të njohim NJM në zonën tonë nëpërmjet metodologjisë së hulumtimit narrativ dhe vizual	Save the Children dhe Terres des Hommes	Shtator 2017–në vazhdim
Rinore	Rinia e Kavajës aktive në qeverisjen lokale	Lëviz Albania	Maj 2017– në vazhdim
Lobim/ advokim për çështje të ofrimit të shërbimeve	Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike në zonën e ish-Kënetës përmes hulumtimit pjesëmarrës dhe vizual	Lëviz Albania	Maj 2017– në vazhdim

